



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres të Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 386/2024

Datë: 13/11/2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, nr. 7/01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 11, (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 18 të Ligjit Nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, si dhe pas pranimit të propozimit nga Agjencia për Ndihme Juridike Falas, me numër të protokollit 226/02 të datës 23.07.2024, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E ZYRAVE MOBILE PËR NDIHME JURIDIKE FALAS

1. Aprovohet propozimi i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për themelimin e Zyrave mobile për ndihmë juridike falas.
2. Themelohen Zyrat Mobile për Ndihmë Juridike Falas në komunat: Kaçanik, Viti, Hani i Elezit.
3. Zyrtarët e Zyrës nga pika dy (2) e këtij vendimi obligohen që detyrat dhe përgjegjësitë t'i kryejnë në pajtim me dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi.
4. Vendi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Ministria e Drejtësisë, me datë 08.11.2024, përmes shkresës më numër të protokollit 01-1985, nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, ka pranuar propozimin për themelimin e Zyrave mobile për ndihmë juridike falas në komunat: Kaçanik, Viti, Hani i Elezit.

Bazuar në 18 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive

të pavarura si dhe me qëllim të ofrimit të ndihmës juridike të qytetarëve të komunës së Kaçanik, Vitisë, Hanit të Elezit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



*Vendimi i dërgohet:*

- Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MD-së;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.